



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS  
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

## Raporti për Tremujorin e Parë 2019

Oda e Mjekëve të Kosovës



Prill 2019


Prishtinë

## Përmbajtja:

Raporti për Tremujorin e Parë 2019 .....	1
1. Anëtarësimi .....	3
2. Mbikëqyrja etiko-profesionale .....	3
3. Edukimi i Vazhdueshëm Profesional .....	5
4. Licencimet .....	5
5. Edukimi specialistik - bartja e kompetencës .....	5
6. Raporti financiar.....	6
6.1 Gjendja financiare – 31 mars 2019.....	6
6.2 Prokurimi.....	7
7. Komisioni për Çështje Etike i OMK-së.....	7
8. Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke i OMK-së: .....	7
9. Funkcionalizimi i OMK-së.....	7
9.1 Infrastruktura juridike.....	7
9.2 Shërbimi profesional .....	8
10. Aktivitete të tjera .....	8
10.1 Faksimilet (Vulat).....	8
10.2 Bashkorganizimi i punëtorisë “Ditët Ndërkombëtare të Menaxhimit të Rrugëve të Frymëmarrjes” .....	9
10.3 Marrëveshjet.....	9
11. Plani i veprimit për 2019 .....	10
11.1 Projektet afatgjata.....	10
11.2 Aktivitetet kyçe për T2/2019.....	10

## 1. Anëtarësimi

- Deri më 31 mars 2019, në OMK u anëtarësuan 3849 mjekë, ku 397 janë mjekë të papunë dhe 40 janë mjekë të huaj, apo 10% dhe 1% respektivisht.
- Në Kuvendin e mbajtur më 17 janar 2019, u mor Vendimi i ri për kuotën e anëtarësisë për vitin kalendarik 2019, me anë të të cilit u përcaktua kuota në shumë prej 80.00 euro për të gjithë mjekët shtetas kosovarë, ndërsa për mjekët shtetas të huaj që janë të angazhuar në sektorin privat, 250.00 euro për vit kalendarik.



## 2. Mbikëqyrja etiko-profesionale

Për ta pasqyruar ecurinë e mbikëqyrjes etike dhe profesionale pranë organeve të Odës, më poshtë është paraqitur në mënyrë tabelare ushtrimi i funksionit të tillë nga ana e organeve të Odës.

Organi	Numri i lëndëve	Vendimet sipas procedurës zhvilluar	Sanksionet shqiptuara	Sanksionet ekzekutuara
Këshilli Etik	26	5	Gjoba 5,500 €	Gjobë 1,000 € Rekomandim Kolegjial,

Organi	Numri i lëndëve	Vendimet sipas procedurës së zhvilluar	Sanksionet e shqiptuara	Sanksionet e ekzekutuara
			Rekomandim Kolegjial dhe Qortim Publik, 1,150 € shpenzime paushalle të procedurës	Qortim Publik 450 € shpenzime të procedurës
Prokurori i Odës	17	5 vendime hetimore	//	//
Gjyqi i Nderit	0	1	Gjobë 1,000€ Rekomandim Kolegjial dhe Qortim Publik 250 € shpenzime paushalle të procedurës	Gjobë 1,000 € Rekomandim Kolegjial, Qortim Publik 250 € shpenzime të procedurës


Në shqyrtime të drejtpërdrejta, janë mbajtur gjithsej 4 seanca të shqyrtimit kryesor, në të cilin është mundësuar përfaqësimi i drejtpërdrejtë i palëve në procedurë, përfshirë të drejtën për përfaqësues me autorizim (prokurë).

### **Sfidat e organeve të OMK-së gjatë ushtrimit të funksionit të mbikëqyrjes etike**

- Ndonëse procedurat disiplinore janë në funksion të mbikëqyrjes etike dhe profesionale, organet e Odës përgjithësisht ballafaqohen me probleme të natyrave si më poshtë:
- Krijimi dhe unifikimi i praktikës procedurale;
- Zhvillimi i koordinimit në mes të institucioneve publike dhe organeve të Odës;
- Nevoja për profilizim profesional të Prokurorisë së Odës, ndonëse për këtë kemi të bëjmë me pengesë ligjore për angazhim të Prokurorëve në numër më të madh që janë me profesion juristë;
- Fenomenologjia e trajtimit të rasteve në raport me përvojën e përgjithshme institucionale të Republikës së Kosovës, si procedurë e zbatuar në praktikë së voni; dhe
- Nevoja për njohjen me praktikat ndërkombëtare lidhur me shqyrtimet etiko-profesionale.


### 3. Edukimi i Vazhdueshëm Profesional

Komisioni për Edukimin e Vazhdueshëm Profesional gjatë tremujorit të parë të këtij viti, ka akredituar 29 aktivitete.



### 4. Licencimet

Komisioni për Licencim dhe Rilicencim gjatë tremujorit e pare të vitit 2019, ka lëshuar licenca me kategoritë si në grafikun më poshtë:



Nga data e bartjes së kompetencës për licencim, ky Komision i ka lëshuar gjithsej 847 licenca.

### 5. Edukimi specialistik - bartja e kompetencës

Dizajnimi dhe fillimi i fazës kalimtare të bartjes së kompetencave të edukimit specialistik (zbërthimi ligjor, financiar dhe teknik) është në proces e sipër, duke përfshirë edhe hartimin e UA për shkollim specialistik.

**6. Raporti financiar****6.1 Gjendja financiare – 31 mars 2019**

<b>1.0 Të hyrat:</b>	<b>Realizimi: TM1</b>
1.1 Të hyrat e shtyera nga 2018	€143,132.50
<b>Të hyrat e shtyera nga 2018</b>	<b>€143,132.50</b>
<b>1.1 Të hyrat nga TM1</b>	
1.1.1 Të hyrat nga anëtarësia:	
1.1.2 Anëtarësimi i mjekëve shtetas kosovarë	€245,993.88
1.1.3 Anëtarësimi i mjekëve shtetas jokosovarë	€9,750.00
1.1.4 Licencimi	€11,367.65
1.1.5 Të hyrat e tjera	€23,179.52
<b>Të hyrat nga TM1</b>	<b>€290,291.05</b>
<b>TOTAL TË HYRAT</b>	<b>€433,423.55</b>

<b>2.0 SHPENZIMET</b>	<b>Shpenzimet: TM1</b>
2.1 Paga dhe kontributet pensionale	€18,199.83
2.2 Mëditjet	€14,260.90
2.3 Material shpenzues	€1,344.41
2.4 Reprerentacioni	€234.21
2.5 Edukimi i vazhdueshëm professional	€5,473.25
2.6 Shpenzimet e tjera	€35,993.22
2.7 Përkrahje financiare në kuadër të fondit për solidaritet	€3,000.00
<b>TOTAL SHPENZIMET</b>	<b>€78,505.82</b>

<b>BILANCI TM1</b>	<b>€354,917.73</b>
--------------------	--------------------

**Sfidat:**

- 21% e anëtarëve të Odës nuk e kanë kryer obligimin e pagesës së kuotës të anëtarësisë në përputhje me Vendimin e Kuvendit të Odës. Disa nga pagesat nuk janë ekzekutuar për shkaqe teknike nga sistemi i pagave të Ministrisë së Financave, kryesisht mjekë të cilët kanë ndërruar vendin e punës por ende nuk e kanë njoftuar Odën për këtë ndryshim, ndërsa pjesa tjetër janë nga sektori privat.
- Me 28 shkurt 2019, nga Thesari i Ministrisë së Financave janë alokuar në mënyrë të gabuar mjetet nga kuota e anëtarësisë së Odës së Infermierëve të Kosovës në xhirollogarinë e OMK-së. Këto mjete janë tërhequr nga

xhiorologaria e OMK-së me urdhër të Thesarit drejtuar Bankës, me 1 mars 2019.

## 6.2 Prokurimi

Gjatë tremujorit e parë të këtij viti u zhvilluan tri procedura të prokurimit:

- Në muajin shkurt u bë Ftesa për Tender nga Oda e Mjekëve të Kosovës të gjitha kompanitë e interesuara që të paraqesin ofertën e tyre për dosje të tenderit për Kontratën e Auditimit Funkcional dhe Financiar të OMK-së. Si rezultat i kësaj ftese u pranua ofertë nga vetëm një operator ekonomik dhe si rrjedhim, për shkak të mospërmbushjes së kushtit për zhvillim të procedurës së prokurimit, u bë anulimi i procedurës.  
Së këndejmi, Ftesa për Tender për Auditim Funkcional dhe Financiar të OMK-së u rishpall me Vendim të Këshillit Drejtues në muajin mars, dhe kësaj radhe nuk u parashtrua asnjë ofertë nga operatorët ekonomikë, dhe përsëri për shkak të mungesës së aplikantëve u bë anulimi i procedurës së prokurimit.
- Ndërsa aktiviteti i prokurimit i cili rezultoi me sukses duke ia ndarë kontratën një operatori ekonomik ishte ai i Furnizimit me orendi për OMK-në në muajin mars. Vlera e kësaj Kontrate arrin shumën prej 3,455.00 €.

## 7. Komisioni për Çështje Etike i OMK-së

Në periudhën kohore korrik 2018 – mars 2019, Komisioni për Çështje Etike i OMK-së ka pranuar dhe ka shqyrtuar pesë (5) kërkesa për leje hulumtimi.

Të pesë (5) kërkesat e shqyrtuara janë aprovuar nga Komisioni për Çështje Etike dhe aplikantëve i është lëshuar leja për hulumtim.

## 8. Komisioni për Solidaritet dhe Ndhmë Reciproke i OMK-së:

Në periudhën kohore janar – mars 2019, Komisioni për Solidaritet dhe Ndhmë Reciproke ka pranuar gjithsej tri (3) kërkesa për përkrahje financiare.

Që të tri (3) këto kërkesa janë aprovuar dhe janë ndarë mjete financiare për të tri kërkesat.

## 9. Funksionalizimi i OMK-së

### 9.1 Infrastruktura juridike

Më 17 janar 2019, u mbajt mbledhja e rregullt e Kuvendit të OMK-së, në të cilën u miratuan plotësim ndryshimet e akteve normative të miratuara në mbledhjen e rregullt të Kuvendit të mbajtur më 19 qershor 2018 dhe po ashtu u miratuan akte të reja normative sa vijon:

- Statuti i OMK-së (plotësim/ndryshim), *pritet aprovimi nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë*
- Kodi i Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore (plotësim/ndryshim),
- Rregullorja për Regjistrimin, Licencimin dhe Rilicencimin e Mjekëve (plotësim/ndryshim);
- Rregullorja për Edukimin e Vazhdueshëm Profesional (plotësim/ndryshim);
- Rregullorja për Përcaktimin e Llojeve të Shkeljeve Etike dhe Procedurat e Mbikëqyrjes Etike (plotësim/ndryshim);
- Rregullorja për Menaxhimin e Financave të OMK-së (plotësim/ndryshim);
- Rregullorja për Punën e Komisionit për Solidaritet dhe Ndhimë Reciproke (plotësim/ndryshim);

Aktet e reja të miratuara në mbledhjen e Kuvendit më 17 janar 2019 janë si në vijim:

- Rregullorja për Procedurat e Prokurimit
- Rregullorja për Udhëtime Zyrtare

Ndërkaq, akte juridike të miratuara nga Këshilli Drejtues i OMK-së:

- Rregullorja për Sistematizimin e Vendeve të Punës në OMK.

Gjithashtu, OMK në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë ka ndërmarrë iniciativën për hartimin e Rregullores për Menaxhimin dhe Mirëmbajtjen e Regjistrit të Institucioneve Shëndetësore në Republikën e Kosovës.

## **9.2 Shërbimi profesional**

Pas aprovimit të organogramit nga Këshilli Drejtues, me 23 mars është shpallur konkurs për tri pozita të stafit të shërbimit profesional. Konkursi është hapur për pozitën Asistent Administrativ pranë komisioneve të përhershme të OMK-së (3 pozita) dhe do të jetë i hapur për 15 ditë nga dita e shpalljes.

## **10. Aktivitete të tjera**

### **10.1 Faksimilet (Vulat)**

- Deri më 31 mars 2019, Oda e Mjekëve të Kosovës ka prodhuar dhe shpërndarë gjithsej 3256 faksimile.





- Afati i shpërndarjes së faksimileve është shtyrë nga Këshilli Drejtues deri më 1 maj 2019, kur edhe hyn në fuqi përdorimi i obligueshëm i tyre.

### 10.2 Bashkorganizimi i punëtorisë “Ditët Ndërkombëtare të Menaxhimit të Rrugëve të Frymëmarrjes”

- Më 2 mars 2019, nën patronazhin e Odës së Mjekëve të Kosovës dhe në bashkorganizim me Shoqatën Kosovare për Menaxhimin e Rrugëve të Frymëmarrjes u organizua punëtorja “Ditët Ndërkombëtare të Menaxhimit të Rrugëve të Frymëmarrjes”.

### 10.3 Marrëveshjet

- Oda e Mjekëve të Kosovës në muajin mars të këtij viti ka lidhur Memorandum Mirëkuptimi me kompaninë e sigurimeve “Scardian” J.S.C. me qëllim të sigurimit të ofertave të veçanta në kuptim të kushteve dhe çmimit për të gjithë anëtarët e saj, në tri opsione të ndryshme.
- Gjithashtu Oda e Mjekëve në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit/mirëkuptimit ka lidhur marrëveshje me kompaninë “Auto Shtëpia Siqani” që ofron zbritje në blerjen e veturave të reja për të gjithë mjekët e anëtarësuar në Odë.

## **11. Plani i veprimit për 2019**

### **11.1 Projektet afatgjata**

- OMK-ja ka marrë iniciativën e projektit për ndërtimin e një objekti për të gjitha OPSH-të, mbështetur nga MSH-ja, financuar nga Projekti KSV/017 “Përkrahja për Sektorin e Shëndetësisë”. Kësaj initiative i janë përgjigjur të gjitha OPSH-të dhe kërkesa zyrtare për mbështetje është nënshkruar nga të gjitha ato, dhe më pas është dorëzuar në MSH.
- Krijimi i sistemit informativ/databazë interaktive, ku do të përfshihen të gjitha proceset e OMK-së. Kohëzgjatja e projektit – 1 vit (Lux Dev).

### **11.2 Aktivitetet kyçe për T2/2019**

- Sigurimet profesionale;
- Bartja e kompetencës për edukimin specialistik;
- Konferenca dhe Panairi i Parë i Shkencave Mjekësore (Këshilli Organizativ është emëruar dhe organizimi tanimë ka filluar)
- Auditimi financiar dhe funksional;
- Konkursi për përkrahje të pesë (5) punimeve shkencore.